



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:072547

Datë: 12.02.2024

Numri i dokumentit: 05313050

KE.nr. 1061/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike të paditëses G.P. me vendbanim në, Republika e Italisë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit H.Sh., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig” Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “2 Korriku”, nr. 4, me objekt kontesti kompensimi i dëmit materiale, vlera e objektit të kontestit të papërcaktuar, jashtë seancës me datën 12.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur sipas padisë së paditëses G.P. me vendbanim në, Republika e Italisë, me numër të lëndës KE.nr. 1061/22, e paraqitur me datë 06.12.2021, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig” Sh.A., me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimi i dëmit material.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë.

A r s y e t i m

Paditësja G.P., përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 06.12.2021, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka paraqitur padi ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig” Sh.A., me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit material.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është transferuar pranë Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike.

Gjykata, pas shqyrtimit paraprak të padisë, në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën lëndore dhe gjeti se Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje, për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 13, pika 1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë *“kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*.

Andaj, meqë në rastin konkret paditësja është person fizik ndërsa Departamenti për Çështje Ekonomike në kuadër të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale është kompetent për të vendosur kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate.

Ndërsa, duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr. 06/L-054), lidhur me nenin 37 dhe 38 të LPK-së, kjo gjykatë vlerëson se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm.

Nga sa u tha më lartë, në mbështetje të dispozitave nga neni 17 dhe 19, lidhur me nenin 387.1, pika u) dhe 392, pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 1061/22, datë 12.02.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.